

FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT

NJOFTIMI PËR MODIFIKIMIN E MARRËVESHJES KUADËR/KONTRATËS GJATË ZBATIMIT

1. Emri dhe adresa e Autoritetit/Entit Kontraktor

Emri Fondi Shqiptar i Zhvillimit
Adresa Rruga “Sami Frashëri”, nr.10 Tiranë
E-mail prokurimet@albaniandf.org
Ueb-faqe www.albaniandf.org

2. Kontaktet e personit (ave) përgjegjës për prokurimin:

E-mail prokurimet@albaniandf.org.

3. Lloji i procedurës së prokurimit: Procedurë e Hapur

4. Lloji i kontratës /Marrëveshjes kuadër: Punë publike.

5. Numri i referencës së procedurës /Lotit: REF-22831-10-04-2024

6. Objekti i kontratës / Marrëveshjes Kuadër: " Ndërtimi i infrastrukturës së modeleve të integruara në zona me potencial zhvillimi, Bulqizë: Parku Tematik Retro, Bulqizë “Divizioni” Loti 1”. Kontratë me çelësa në dorë.

7. Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP): Punë Ndërtimi- 45000000-7.

8. Fondi limit: 338,665,777.77 Lekë pa TVSH. Programi buxhetor GOA për periudhën 2024-2026, Kodi i Projektit 24AC301.

9. Situata sipas parashikimeve të nenit 127 të LPP dhe argumentet përkatëse për ta përdorur atë: Nenin 127, pika 1, shkronja “c” të Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, i cili parashikon se kontrata mund të modifikohet gjatë kohëzgjatjes së saj në rastet kur ndryshimi është bërë i domosdoshëm si pasojë e rrethanave të paparashikueshme, pa ndryshuar në thelb natyrën e kontratës;

Gjatë zbatimit të kontratës dhe në fazën e hartimit të projektit të zbatimit janë konstatuar rrethana teknike të paparashikueshme të cilat nuk kanë qenë të identifikueshme nga AK apo nga operatori ekonomik. Këto rrethana lidhen konkretisht me objektin “Hotel” për të cilin fillimisht nga Raporti i Vlerësimit Teknik i paraqitur nga kontraktori dhe më pas nga Akt-Ekspertiza e Institutit të Ndërtimit është konstatuar:

- Objekti “Hotel” ekzistues paraqet dëmtime të rënda strukturore dhe jo strukturore;
- Ekziston rrezik real shëmbjeje dhe cënim serioz i sigurisë së jetës së njerëzve;
- Ndërhyrjet e rikonstruksionit nuk mund të garantojnë përmbushjen e kërkesave të normativave bashkëkohore antisizmike;
- Rekomandohet shëmbja e objektit dhe ndalimi i hyrjes së personave.

Si pasojë e këtyre konstatimeve, realizimi i këtij objekti “Hotel”, nuk përbën më një çështje detajimi teknik apo riorganizimi funksional e trajtueshme në fazën e projektit të zbatimit, por kërkon studim dhe projektim të ri konstruktiv, si dhe zëra të rinj punë (shëmbje, leje, mbikëqyrje etj.), të cilët nuk janë parashikuar në kontratën ekzistuese dhe nuk mund të realizohen brenda saj pa ndryshuar në

mënyrë thelbësore objektin dhe përmbajtjen e kontratës. Për rrjedhojë kontrata duhet të modifikohet duke hequr objektin “Hotel” i cili përbën rreth 18.95% të vlerës totale të kontratës.

10. Përshkrimi i modifikimit të kontratës/Marrëveshjes Kuadër, përfshirë natyrën dhe sasinë ose vlerën e punimeve

Modifikimi konsiston në heqjen nga kontrata të objektit “Hotel”, i cili përbën rreth 18.95% të vlerës totale të kontratës.

Si rezultat:

- Vlera e kontratës ndryshon nga 243,383,936 lekë pa TVSH dhe 292,060,723 lekë me TVSH, në 197,271,932 lekë pa TVSH dhe 236,726,319 lekë me TVSH.
- Afati i realizimit ndryshon nga 24 muaj në 19 muaj e 13 ditë nga data e fillimit të punimeve.

11. Vlera totale e kontratës së nënshkruar/marrëveshjes kuadër: 243,383,936 lekë pa TVSH dhe 292,060,723 lekë me TVSH,

12. Vlera e ndryshuar (nëse është rasti): 197,271,932 lekë pa TVSH dhe 236,726,319 lekë me TVSH

13. Kohëzgjatja e kontratës / Marrëveshjes Kuadër: 24 muaj

14. Dhe afati i ri (nëse është rasti): 19 muaj e 13 ditë nga data e fillimit të punimeve.

15. Emri dhe adresa e operatorit/ëve Ekonomik:

OE “ULZA” shpk me NIPT J679029280 me adrese: Njesia bashkiake nr 5, rruga Zef Jubani, ndertesa 15, hyrja 19, ap 1, kodi postar 1019, Tirane.

Subjekt Mbështetës: “ALMO KONSTRUKSION” shpk NIPT J91915001P me adrese: Tirane Kamez Lagjia Zall - Mner i Ri, Rruga Nacionale Kamez, 1054

Data e nënshkrimit të modifikimit: 20.04.2026

16. Burimi i financimit: Buxheti Shtetit

17. Informacion tjetër që vlerësohet i nevojshëm nga autoriteti/enti kontraktor: _____